

NJOFTIM

MBI APLIKIMIN E APLIKUESIT “ERA HYDRO” SH.P.K., PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT “BLINETA” ME KAPACITET PRODHUES DERI NË 2 MW, NË LUMIN FAN I MADH, PRANË FSHATIT GOJAN I EPËRM, BASHKIA PUKË, QARKU SHKODËR

Në përputhje me Ligjin nr.43/2015, datë 30.04.2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe VKM nr. 822 datë 07.10.2015 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”, i ndryshuar, Aplikuesi “Era Hydro” sh.p.k., ka aplikuar në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, për miratimin e ndërtimit të hidrocentralit “Blineta”, me kapacitet prodhues deri në 2 MW, në lumin Fan i Madh, pranë fshatit Gojan i Epërm, Bashkia Pukë, Qarku Shkodër.

- Shoqëria “ERA HYDRO” SH.P.K., është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me objekt të aktivitetit: Import – eksport dhe tregtim me shumicë dhe pakicë të artikujve të ndryshëm, industrial, bujqësor, blektoral, ushqimor, materialeve të ndërtimit, inerteve, të konfeksioneve, parkete e mokete, pajisje zyrash, duralumini, metaleve, hidrosanitare, elektro shtëpiake, elektronike, kondicioner, elektrike dhe hidraulike. Të kryejë aktivitete në fushën e energjitikës, me synim gjetjen dhe shfrytëzimin e burimeve energjitike, si dhe çdo ndërtim tjetër me karakter civil dhe ekonomik përfshirë dhe Hidrocentralet apo çdo objekt tjetër për prodhimin, shitjen e transmetimin e energjisë. Prodhimin dhe tregtimin me shumicë e pakicë të energjisë elektrike. Transport mallrash dhe materialesh për vete dhe për të tretët.

Një informacion më i detajuar lidhur me projektin mund të gjendet pranë Drejtorisë së Koncesioneve, Prokurimeve, Shpronësimeve dhe Privatizimit në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë.

Objeksionet ose komentet lidhur me këtë aplikim mund të dërgohen në adresën e mëposhtme brenda 15 ditësh nga data e publikimit.

Ministria e Energjisë dhe Industrisë.

Drejtoria e Koncesioneve, Prokurimeve, Shpronësimeve dhe Privatizimit

Blvd. Dëshmorët e Kombit, 1001

Tiranë